



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:257779

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05382917

C.nr.766/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve G.E nga fshati Nagavc, Komuna e Rahovecit, M.K nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, N.K nga fshati Nagavc, Komuna e Rahovecit, S.G nga fshati Nagavc, Komuna e Rahovecit dhe Sh.S-B nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson S.M, avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Prishtinë, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 3,840.40 euro, jashtë seance me datë 27.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve G.E, M.K, N.K, S.G dhe Sh.S-B.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit G.E nga fshati Nagavc, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 488.36 euro, në **shumën e përgjithshme prej 670.22 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.12.2022, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit M.K nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 488.36 euro, në **shumën e përgjithshme prej 670.22 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.12.2022, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit N.K nga fshati Nagavc, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020 në shumën prej 11.86 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 201.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 573.64 euro, në **shumën e përgjithshme prej 787.26 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.12.2022, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit S.G nga fshati Nagavc, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 488.36 euro, në **shumën e përgjithshme prej 670.22 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.12.2022, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Sh.S-B nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020 në shumën prej 10.10 euro, për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 488.36 euro, në **shumën e përgjithshme prej 670.22 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 06.12.2022, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

VII. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit G.E, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 670.22 euro e deri në shumën 770.97 euro, dhe atë në shumën prej 100.75 euro.

VIII. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit M.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 670.22 euro e deri në shumën 759.67 euro, dhe atë në shumën prej 89.45 euro.

IX. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit N.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 787.26 euro e deri në shumën 847.15 euro, dhe atë në shumën prej 59.89 euro.

X. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit S.G, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 670.22 euro e deri në shumën 736.98 euro, dhe atë në shumën prej 66.76 euro.

XI. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses Sh.S-B, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 670.22 euro e deri në shumën 725.63 euro, dhe atë në shumën prej 55.41 euro.

XII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve ti paguaj shumën prej 333.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit, ndërsa refuzohet pjesa tjetër e shpenzimeve procedurale mbi shumën e aprovuar prej 333.00 euro e deri në shumën 645.00 euro dhe atë për shumën prej 312.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësit G.E, M.K, N.K, S.G dhe Sh.S-B në këtë gjykatë me datë 06.12.2022, përmes të autorizuarit të tyre S.M, avokat në Prizren, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se në bazë të nenit 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe 22.01.2022 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhen të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor. I autorizuari i paditësve përmes parashtrësës së datës 21.12.2023 ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që paditësve në emër të kompensimit të shtesë mbi bazën e përqindjes të inflacionit të iu paguaj dhe atë paditësit G.E: 1. për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 11.69 euro, 2. për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 198.83 euro, si dhe 3.për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 560.45 euro, në shumën e përgjithshme prej 770.97 euro. Paditësit M.K: 1. për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 11.52 euro, 2. për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 195.92 euro, si dhe 3. për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 552.23 euro, në shumën e përgjithshme prej 759.67 euro. Paditësit N.K: 1. për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 12.85 euro, 2. për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 218.48 euro, si dhe 3. për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 615.82 euro, në shumën e përgjithshme prej 847.15 euro. Paditësit S.G: 1. për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 11.18 euro, 2. për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 190.07 euro, si dhe 3. për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 535.73 euro, në shumën e përgjithshme prej 736.98 euro. Paditëses Sh.S-B: 1. për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 11.00 euro, 2. për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 187.14 euro, si dhe 3. për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 527.49 euro, në shumën e përgjithshme prej 725.63 euro. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërsi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 18.08.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore.

Kërkesëpadinë e paditësve e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Paditësit kanë parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 06.12.2022, andaj konsiderojmë që kërkesëpadia e paditësve është parashkruar në tërësi ngase nga hyrja në fuqi e KKAK, të datës 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në këtë gjykatë kanë kaluar më shumë se 3 vite. Paditësit nuk i kanë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditëset të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Nesimi Elshani”, në fshatin Nagavc, Komuna e Rahovecit. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2021 vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësve: G.E, M.K, S.G dhe Sh.S-B është në shumën prej 421.00 euro, ndërsa lartësia e pagës bazë e paditësit N.K është në shumën prej 494.52.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në*

bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve A.I, B.B, F.E dhe Z.G i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II, III, IV, V, dhe VI. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (datë e parashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë në pjesën tjetër në shumën prej 100.75 euro për paditësin G.E, në shumën prej 89.45 euro për paditësin M.K, në shumën prej 59.89 euro për paditësin N.K, në shumën prej 66.76 euro për paditësin S.G, si dhe në shumë prej 55.41 euro për paditësen Shqipe - Skenderi Behra. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësit përfitojn ngritje në bazë të pagës bazë (421 euro) dhe jo në bazë të pagës mujore (487.35 euro) për paditësin G.E, në bazë të pagës bazë (421 euro) dhe jo në bazë të pagës mujore (480.20 euro) për paditësin M.K, në bazë të pagës bazë (494.52 euro) dhe jo në bazë të pagës mujore (535.50 euro) për paditësin N.K, në bazë të pagës bazë (421 euro) dhe jo në bazë të pagës mujore (465.86 euro) për paditësin S.G, si dhe në bazë të pagës bazë (421 euro) dhe jo në bazë të pagës mujore (458.69 euro) për paditësen Sh.S-B.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”.*

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtuftjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”,* ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 21 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 333.00 euro.

Pjesa tjetër e kërkesës për shpenzimet procedurale mbi shumën e aprovuar është refuzuar me arsyetim se paditësit kanë kërkuar shumën prej 312.00 euro, në emër të precizimit të kërkesëpadisë, mirëpo gjykata këto shpenzime nuk i ka njohur, pasi që nuk hyjnë në shpenzimet të procedurës gjyqësore. Andaj, e ka refuzuar pjesën e shpenzimeve procedurale mbi shumën e gjykuara prej 333.00 euro e deri në shumën 645.00 euro dhe atë për shumën prej 312.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.766/2022, më datën 27.02.2024

Bashkëpunëtore profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.